



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1495 Prot.

Vlorë më 30.05.2025

VENDIM

Nr. 40, datë 30.05.2025

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BA NR.24, DATË 11.06.2025,
"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PROÇEDURËN E PUNËSIMIT E
PERSONELIT ADMINISTRATIV PËR POZICIONIN E PUNËS "MIRËMBAJTËS",
PRANË SEKTORIT TË SHËRBIMEVE NË DSHM"

Në mbështetje të nenit 49, pika 1 gërma f të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", si dhe referuar propozimit të Administratorit të UV-së ardhur me shkresën nr.1495, prot, datë, 27.05.2025, "Për një ndryshim në kriteret e punësimit" Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 30.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Administratorit të UV-së për një ndryshim në vendimin nr.24 të BA datë 11.06.2025, "Për miratimin e kriterëve për procedurën e punësimit e personelit administrativ për pozicionin e punës "mirëmbajtës", pranë Sektorit të Shërbimeve në DSHM si më poshtë vijon:
 - Në kriteret e vecanta **të shtohet kriteri** "Dëshmi kualifikimi nga Qendra e Formimit Profesional me profil, ose Elektricitist, ose Hidraulik, ose Mobilier"
 - Te dokumentacioni i kërkuar **të shtohet**: "Kopje e noterizuar e dëshmisë përkatëse të kualifikimit nga Qendra e Formimit Profesional.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi kriteret e punësimit të ndryshuara.
3. Ngarkohet Sektori i IT-së të bëjë shpalljen zyrtare në faqen Web të UV-së.
4. Ngarkohet sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës për ndjekjen eafateve për pozicionin e punës "Mirëmbajtës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA



KRITERET E PUNËSIMIT
PËR POZICIONIN E PUNËS “MIRËMBAJTËS” NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORE

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mirëmban ambjentet mësimore dhe jo mësimore.
- Konstaton dhe riparon dëmet për mirëfunksionimin e punës në institucion.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësojë/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit etiko-profesional me kolegët dhe eprorët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Isamil Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve drejtuese , në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

Kriteret të veçanta që duhet të plotësojë/në kandidati/ët

- Të ketë mbaruar minimalisht arsimin e mesëm
- Dëshmi kualifikimi nga Qendra e Formimit Profesional me profil, ose Elektriçist, ose Hidraulik, ose Mobilier” - (Sipas nevojave dhe prioriteteve të Institucionit).
- Eksperienca të mëparshme të punës në fushën e kërkuar përbën avantazh.
- Preferohet të jetë banor në qytetin e Vlorës.

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti, gjendet në adresën (www.univlori.edu.al),
- Jetëshkrim/Curriculum Vitae,
- Diploma e shkollës së mesme (kopje e noterizuar),
- Kopje e noterizuar e dëshmisë përkatëse të kualifikimit nga Qendra e Formimit Profesional.
- Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar),
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal),
- Vendim i gjendjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin),
- Letërnjoftimi ID (fotokopje)

Shënim: *Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr/ 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"*

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën:

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.

Aplikim për punësim/pozicioni i punës:

"Për personel administrativ me angazhim me kohë të plotë në pozicionin "Mirëmbajtës" pranë Sektorit të shërbimeve".

Lagja: "Pavarsia", Rr: "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri

Afati për aplikim

✓ Afati për të aplikuar është 10

(dhjetë) kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së.